

**AKT THEMELEMI**  
**I**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**LAAGO INVEST SHPK**

**NENI 1**

Në Tiranë, sot më datën 16/05/2023 , në bazë të Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 ‘Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare’ dhe Ligjit Nr.9723 date 03.05.2007 “Per Qëndrën Kombëtare te Regjistrimit”, themelohet shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar me emërtimin **LAAGO INVEST SHPK**

**NENI 2**

Ortaku i vetëm i shoqërisë është:

- Znj. Larisa Agovi, e bija e Ylli dhe Xheni Agovi lindur në Tiranë, më 05/02/1987 dhe banues në Tiranë, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar ,identifikuar me kartë identiteti Nr. Personal I75205063H.

**NENI 3**

**Emërtimi**

Emërtimi i plotë i shoqërisë është Shoqeria me Përgjegjesi te Kufizuar **LAAGO INVEST SHPK**

**NENI 4**

**Selia**

Seli e Shoqerise **LAAGO INVEST SHPK** do te jetë :


Rruga e Elbasanit, Pallati 10/1, Kati 8 , Njesia Administrative Nr.2 , Tirane .

Përvec ushtrimit të aktivitetit në nivel qendror, shoqëria ka të drejtë të hap degë dhe zyra perfaqësimi brënda vëndit ose jashtë vëndit. Selia e Shoqerisë mund të ndryshoj me vendim të Asamblesë së Përgjithëshme.

**NENI 5**

**Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë është me afat të pacaktuar, dhe do të fillojë nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, me përjashtim të rastit kur mbaron sipas parashikimeve të ligjit ose kur vendos Asambleja e Përgjithëshme.



**NENI 6**  
**Objekti i Veprimtarisë**

Objekti i Veprimtarisë është:

Projekte ndertimore me celsa ne dore. Punime civile ndertimore deri ne fazen e arredimit te brendshem te plote deri ne detajet dekorative.

Ne fazen ndertimore perfshihet: qe nga ndjekja dhe supervizimi i punimeve ndertimore ne kantier, punime ndertimore, punime gipsi, elektriket, muret tulle, sisteme mekanike dhe kondicionimi, hidroizolime, sisteme hidraulike, punime fasade, konstrukcion metalike, sisteme fasadash te ventiluara ose te thjeshta, vetrata, veshje me kapote, veshje me gur ose punime dhe materiale te ndryshme dekorative, shtrime dyshemesh me pllake, parket, rezine, punime pishine etj.

Ne fazen e mobilimit perfshihet qe nga; dezajn dhe konceptim i mobiljeve per banesa, dyqane, zyra etj, prodhimi i mobiljeve lokalisht dhe importi nga jasht ne baze te kerkesave te projektit. Keto punime do te realizohen nga persona te punesuar ne kompani ose me nenkontratim, paleve te treta.

**NENI 7**  
**Kapitali Themeltar**

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë 100 (njëqind ) Leke, i zotëruar nga ky ortak:

Emri, Mbiemri	% që zotëron	Kuotat që zotëron	Shuma e kapitalit
Larisa Agovi	100%	1	100 lekë

**NENI 8**

Administrator i shoqërisë do të jetë Znj. Larisa Agovi, e bija e Ylli dhe Xheni Agovi lindur në Tiranë, më 05/02/1987 dhe banues në Tiranë, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar ,identifikuar me kartë identiteti Nr. Personal I75205063H

**NENI 9**

Drejtimi, organizimi dhe funksionimi i shoqërisë rregullohet sipas dispozitave te legjislacionit shqiptar si dhe ne baze te Statutit dhe ketij Akti Themelimi.

**NENI 10**  
**Dispozita e fundit**

Ky akt themelimi është perpiluar në 2 (dy) kopje, në gjuhën shqipe, me vlerë të njëjtë ligjore.

**Ortaku i vetëm i Shoqërisë**  
**Larisa Agovi**

Larisa Agovi

